



Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received / Delivery	11. 05 2021	viti god year	
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIQMSR	2334/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.279/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.279/2021 të datës 15.04.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati Gllobarë, rruga "Shaban Polluzha", Nr. 223 në Komunën e Drenasit, kundër organit të punësimit/Agjencia e Shoqërisë së Informacionit-Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 11.05.2021, mori këtë

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.279/2021 e datës 15.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 04.01.2016 në pozitën "Administrator i Lartë i T1-së për Rrejtën Mikrovalor" në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, më datë 19.01.2021 përmes emailit ka "kërkuar nga Inspektoratit Sanitar i AUV-s që të merret me ankesën time drejtuar dy udhëheqësve të cilët ka disa raste që organizojnë takime punë në ambient kundër rregullave dhe ligjit të pandemisë Covid 19, ambient i cili nuk ka as një gjysmë metër/katror për trembëdhjetë pjesëmarrës". Më datë 22.01.2021 Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka përgatitur raportin i inspektimit, ndërsa më 25.01.2021 ka njoftuar se në momentin e inspektimit gjithçka ishte në rregull, respektoheshin masat për ligjin anti Covid 19 dhe vendimet e Qeverisë.

Ankuesi më datë 11.02.2021 nëpërmjet e-mailit ka kërkuar nga z. [] që të shqyrtohet ankesa me arsyetim se: "kërkoj nga ana juaj të merreni masa siç parasheh ligji për zyrtarët publik, për znj. [] cila në vazhdimësi prej se kam kërkuar me shkrim të respektohet

masat anti Covid 19, e njëjta qëllimshëm për shkak që kam bërë kërkesë me shkrim pran juve, organizon me vetëdije takime në zyrën 219 duke ditur se unë nuk do të bindem një kërkesë antiligjore dhe e përdor si shkak i mos respektimit të hierarkisë pran Komisionit Disiplinor. Tani në raportin e nxjerrë nga Inspektorati Sanitar i AUV-s (mendoj) bënë edhe vepër penale duke e shfajësuar veten dhe dezinformuar inspektorët...I nderuar Drejtor nga fillimi i vitit 2019 kur ka filluar me shfrenim të veprimeve zyrtare dhe gojore, vërejte të pabaza ndaj meje, asnjëherë nuk ka parë nga ana juaj një reflektim me shkrim ndaj saj, andaj keni parasysht se këto kërkesat e mia më nuk do të mbesin vetëm në institucionin ku ne punojmë, dhe njëkohësisht i bëjë me dije hierarkisë se këto veprime të tyre të pa ligjshme, mua më bëjnë edhe më të fortë dhe rezistent (nuk jam nga ata të nderuar profesionist më të mirë që kanë ikur dekada shkak i pamundësisë së përbaljes me të keqen)". Bazuar në këtë më datë 18.03.2021 ankuesi është njoftuar nga [] se lidhur me shqetësimet e ngritura nëse jeni aktualisht në zyrë ju mund të vini sot në ora 14 e 45 ose ë shohim një moment tjetër.

Ankuesi më datë 15.04.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 1802/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet kundër se në vazhdimësi Udhëheqësi i Njësisë së Administrimit të Rrjetit Shtetëror-DRRT, Udhëheqësi i Drejtorit të Rrjetit dhe Telekomunikimit-ASHI dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit-MPB, bëjnë shkelej të ligjeve dhe kodit të etikës në raport me punën time profesionale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 21.04.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli më datë 27.04.2021 dhe 30.04.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme respektivisht nga personat ndaj të cilëve është parashtruar ankesa.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 15.04.2021 me numër protokollit 1802/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 18.03.2021; E-mailin e datës 11.02.2021 nga ankuesi; E-mailin e datës 25.01.2021 për ankuesin; E-mailin e datës 25.01.2021 nga [] E-mailin e datës 22.01.2021, 19.01.2021 nga ankuesi; E-mailin e datës 19.01.2021 nga Merita Seferi; E-mailin e datës 14.07.2020 dhe 10.07.2020 nga ankuesi; Faturë e datës 13.02.2019 dh 13.03.2019; Kontrata Publikë Kornizë-Shërbim datë 31.08.2018; Garancion për Ekzekutim Nr. G0118/219 nga NLB Banka; E-mailin e datës 18.10.2018 nga [] E-mailin e datës 18.10.2018 nga [], E-mailin e datës 24.12.2018 dhe 13.12.2018 nga [] E-mailin e datës 24.12.2018, 13.12.2018, 07.12.2018 nga [] E-mailin e datës 05.12.2018 dhe 07.12.2018, 09.07.2019 nga ankuesi; E-mailin e datës 29.11.2018 nga [] E-mailin e datës 07.12.2018, 14.03.2019 nga [] E-mailin e datës 07.12.2018 nga [] E-mailin ASHI të datës 14.03.2019; E-mailin e datës 05.04.2019 nga [] E-mailin e datës 04.04.2019 nga [] E-mailin e datës 04.04.2019 nga ankuesi; E-mailin e datës 22.03.2019, 03.04.2019 nga [] E-mailin e datës 02.04.2019 nga [] E-mailin e datës 02.04.2019 nga ankuesi; E-mailin e datës 03.04.2019 nga Merita Seferi; E-mailin e datës 05.04.2019, 24.07.2019 nga ankuesi; Vendimin me Nr. 3/2018 i datës 01.08.2019 i Komisionit Disiplinor të MAP; E-mailin e datës 06.08.2019, 09.07.2019 nga ankuesi; E-mailin e datës 23.03.2021 nga [] E-mailin e datës 23.03.2021 nga ankuesi;


E-mailin e datës 22.03.2021 nga	E-mailin e datës 22.03.2011 nga
E-mailin e datës 06.04.2021 nga	E-mailin e datës 02.04.2021 nga ankuesi;
Kërkesën për pushim vjetor; Akt Emërimit e datës 04.10.2016; Vendimin me Nr. 01-11-13/2021 i Inspektoratit të Punës i datës 11.03.2020; Vendimin me Nr. 01/2021 i datës 23.03.2021 i Komisionit Disiplinor i MPB-së; Vendimin me Nr. 521/2020 i datës 22.12.2020 i Komisionit Disiplinor i MPB; Raportin Zyrtar të Inspektoratit të Punës Nr.17/2021; Procesverbalin e datës 22.01.2021 të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë; E-mailin e datës 12.08.2020 nga	
E-mailin e datës 07.08.2020 nga	E-mailin e datës 07.08.2020 nga ankuesi;
E-mailin e datës 07.08.2020 nga	E-mailin e datës 29.05.2019, 28.05.2019, 27.05.2019 nga
E-mailin e datës 15.01.2019 nga	E-mailin e datës 02.05.2018 nga
E-mailin e datës 20.04.2018 nga	E-mailin e datës 19.04.2018 nga
ankuesi; E-mailin e datës 05.04.2019 nga	E-mailin e datës 17.09.2021 nga ankuesi;
E-mailin e datës 17.09.2020 nga	dhe përgjigjen e datës 27.04.2021; Përgjigjen në
ankesë e datës 29.04.2021; Kërkesa për pushim vjetor e datës 16.10.2020; E-mailin e datës 25.02.2020, 11.02.2020 nga	Raport i prezencës në punës dhe mbështetja
nga distanca; E-mailin e datës 29.03.2021 nga	dhe

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar të gjitha provat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e palejuar sepse:**

Bazuar në të gjitha provat e lëndës, respektivisht bazuar në procesverbalin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë më të cilin është shqyrtuar kërkesa e ankuesit për inspektim në institucionin ku punon lidhur me mos respektimin e masave kundër Covid 19, më konkretisht bazuar në e-mailin e datës 25.01.2021 të *ka njoftuar se në momentin e inspektimit gjithçka ishte në rregull, respektoheshin masat për ligjin anti Covid 19 dhe vendimet e Qeverisë*, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqenëse organi komentet që ka bërë inspektimin ka konstatuar që gjithçka ishte në rregull, atëherë nuk mund të konstatohet që ka pasur shkelje të rregullave të pandemisë, rrjedhimisht nuk mund të konstatohet se janë dezinformuar inspektorët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë siç pretendon ankuesin në kërkesën e datës 11.02.2021, sepse nuk kemi asnjë provë për të provuar pretendimin.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në provat e lëndës ka konstatuar që ankuesi në kërkesën e datës 11.02.2021 ka kërkuar që vetëm ndaj znj. të merren masat, ndërsa në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendimet e tij janë që Udhëheqësi i Njësisë së Administrimit të Rrjetit Shtetëror-DRRT, Udhëheqësi i Drejtoratit të Rrjetit dhe Telekomunikimit-ASHI dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit-MPB, bëjnë shkelje të ligjeve dhe kodit të etikës në raport me punën time profesionale, në këtë rast përveç për znj. ankuesi nuk ka parashtruar kërkesë tek institucionet gjegjëse për dy personat e tjerë, sepse nëse një nëpunës dyshon për shkelje disiplinore të kryera nga nëpunës të tjerë të njëjtit institucion, duhet të raportojnë atë me shkrim mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të nëpunësit civil për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen, siç parashihet me nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, në rastin konkret ankuesit nuk ka vepruar në mënyrë të tillë për të gjitha palët.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se nuk ka asnjë dëshmi që ndaj ankuesit janë bërë shkelje të ligjeve dhe kodit të etikës në raport me



punën e tij profesionale, rrjedhimisht në bazë të këtyre nuk i është shkelur asnjë drejtë nga marrëdhënia e tij e punës, bazuar në këtë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mund të parashtrajnë vetëm nëpunësit civil të cilëve iu janë shkelur të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil siç përcaktohet me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se: ***“Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...”***, dhe nenin 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: ***“Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim”***.

Ndërsa lidhur me pretendimet e tjera të ankuesit për gjoja shfuqizimin e aneksë kontratës për shërbimin VPN, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se kjo fushë nuk hynë në fushëveprimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.


Andaj bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 124 paragrafit 1 dhe nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankuesit është e palejuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.279/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

